



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe

EC MA NDRY SHE

THIRRJE PËR OFERTË

Videoanimacion mbi ndryshimet klimatike dhe

Videoreportazhe mbi ndryshimet klimatike

Projekti “Public Spaces 4 All”, i cili zbatohet nga EC Ma Ndryshe, me mbështetje nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe Sekretariati Shtetëror i Zvicrës për Çështje Ekonomike (SECO), përmes GIZ Kosova.

EC Ma Ndryshe është njëra nga organizatat përfituese të këtij projekti, në kuadër të të cilit shpall këtë thirrje përmes së cilës fton ekspertët/grupet e ekspertëve, kompanitë/konsorciumet dhe OJQ-të e interesuara të dorëzojnë ofertat e tyre për krijimin e një Videoanimacion mbi ndryshimet klimatike si dhe dy Videoreportazheve mbi ndryshimet klimatike.

Videoanimacioni do të jetë një film i shkurtër edukativ që promovon krijimin e hapësirave publike të ndjeshme ndaj ndryshimeve klimatike, përmes animacioneve dhe ilustrimeve të qarta. Për realizimin e tij mund të përdoren mjete dhe platforma të ndryshme të inteligjencës artificiale (AI), të kombinuara me dizajn grafik dhe montazh video, për të krijuar një produkt modern dhe tërheqës.

Videoreportazhi do të realizohet në stil dokumentar dhe do të sjellë në fokus zërat dhe rrëfimet e komunitetit lokal në Prizren, duke pasqyruar përvojat, sfidat dhe perspektivat e tyre. Për krijimin e tij mund të përdoren pajisje të ndryshme të inteligjencës artificiale (AI), së bashku me teknika të xhirimit dhe montazhit profesional, për të prodhuar një përmbajtje autentike dhe tërheqëse.

Gjatë realizimit të videove duhet të merren parasysh që kohëzgjatje e tyre. Videoanimacioni duhet të jetë minimum 0.45 sec dhe maksimumi 3 minutë, ndërsa videanimacioni minimum 0.45 sec dhe maksimum 15 minutë; videot duhet të jenë të realizuara në përputhje me specifikat për publikim në Facebook, Tik Tok, Instagram, Youtube dhe website; muzika apo audio e përdorur në video duhet të jetë më të drejta të siguruara; videot të jenë të realizuara në format jo më të vogël se Full HD.

Kriteret për ofertim:

-Oferta duhet të përmbajë dokumentet në vijim:

-Për ekspertet/grupet e ekspertëve dërgohen vetëm CV-të e personave përgjegjës;

OJQ Emancipimi Civil Ma Ndryshe (EC Ma Ndryshe)

Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren ~ Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7, 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org ~ info@ecmandryshe.org ~ 029-222-771 & 038-224-967

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit/OJQ,
- Çertifikata e numrit fiskal;
- Çertifikata e TVSH- së (kompanitë që janë deklaruese të TVSH-së);

Pala ofertuese duhet të caktojë një person për kontakt direkt dhe komunikim me EC Ma Ndryshe;

Ofertat duhet të dorëzohen fizikisht në zyrat e EC Ma Ndryshe, Rr. Fehmi Lladrovci 67, Prizren ose në mënyrë elektronike në apliko@ecmandryshe.org deri më 07.07.2026 ,ora 16:00 me shënim **“Videoanimacion dhe videoreportazh mbi ndryshimet klimatike”**.

Ofertat që vijnë pas këtij afati dhe ato që nuk i përmbajnë dokumentet relevante, nuk do të konsiderohen.

Për pyetje shtesë rreth kësaj thirrjeje mund të na kontaktoni në: apliko@ecmandryshe.org deri më 06.07.2026.

Pas vlerësimit fillestar të ofertave, EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën të kërkojë dokumente (dëshmi) shtesë nga ekspertet/ grupi i ekspertëve/ kompanitë / OJQ-të, nëse këtë e vlerëson të nevojshme. EC Ma Ndryshe rezervon të drejtën për të negociuar ofertën financiare. Vetëm kompanitë/konsorciumet/OJQ-të fitues do të informohen/kontaktohen.

Me respekt,
OJQ EC Ma Ndryshe
038 731 420 & 049 714 024
apliko@ecmandryshe.org